



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**ZYRA E RREGULATORIT PËR ENERGJI**  
**REGULATORNI URED ZA ENERGIJU**  
**ENERGY REGULATORY OFFICE**



**Prishtinë, 02 shtator 2021**  
**Kodi i ZRRE-së: V\_1343\_2021**

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji**

**Duke u bazuar në:**

- Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, Nenin 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.15, Nenin 25, Nenin 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe Nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 25 të Rregullës Nr. 11/2017 për Procedurën e Autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja bazuar në Burimet e Ripërtitshme të Energjisë; Nenin 18, 19 dhe 20 të Rregullës Nr. 10/2017 për Skemën Mbështetëse për Gjeneratorët e BRE-ve, dhe
- Aplikacionin për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë - konsum nga panelet solare/fotovoltaike, në objektin ngastrada kadastrale nr. 1700-2-631-0 ZK Çagllavicë me kapacitet të instaluar prej 5 kW në Komunën e Graçanicës, të datës 24.12.2020 me nr. prot. 773/20 të aplikuesit personit fizik Nehat Humolli, me adresë: "Çagllavicë" Komuna Graçanicës, Republika e Kosovës.

**në seancën e mbajtur më 02 shtator 2021 nxori këtë:**

**V E N D I M**

**PËR NDËRTIMIN E KAPACITETEVE GJENERUESE PËR VETË-KONSUM**

- I. APROVOHET** - kërkesa e aplikuesit personit fizik Nehat Humolli për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike, në objektin ngastrada kadastrale nr. 1700-2-631-0 ZK Çagllavicë me kapacitet të instaluar prej 5 kW në Komunën e Graçanicës.
- II. OBLIGOHET** – aplikuesi personi fizik Nehat Humolli me shifër të regjistruar të njehsorit elektrike DPR - 901116774 që pas ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë-konsum, të parashtrij kërkesë në KEDS SH.A., për pranim teknik të objektit energjetik.
- III. ZRRE** do të konsideroj projektin e finalizuar nga data e pranimit teknik sipas Pëlqimit Elektroenergjetik të lëshuar nga KEDS SH.A.
- IV. Aplikuesi personi fizik Nehat Humolli** do të lidh Marrëveshje për vetë-prodhim me furnizuesin me të cilën ka kontratë për furnizim me energji elektrike, pas konfirmimit të pranimit teknik nga KEDS SH.A., në pajtim me nenin 18 paragrafi 1 dhe 2 i Rregullës Nr. 10/2017 për Skemën Mbështetëse.

**A r s y e t i m**

- o ZRRE, me datë 24.12.2020 nga aplikuesi personi fizik Nehat Humolli, ka pranuar aplikacionin për marrjen e vendimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga



panelet solare/fotovoltaike, në objektin ngastra kadastrale nr. 1700-2-631-0 ZK Çaglavicë me kapacitet të instaluar prej 5 kW në Komunën e Graçanicës.

- Aplikuesi, s'bashku me aplikacionin ka bashkangjitur edhe dëshminë nga KEDS për konsumin vjetor të energjisë elektrike, vlerësimin për prodhimin vjetor në kW/h të pajisjeve të instaluara, pëlqimin elektroenergjetik Nr. 7932 të datës 16.08.2021 të lëshuar nga KEDS SH.A., dhe Pëlqimin Nr. II. 941/20 dt. 16.12.2020 të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizimit, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Graçanicës.
- Bordi i ZRRE-së, pas analizimit të kërkesës së aplikuesit personit fizik Nehat Humolli dhe dëshmime të bashkangjitura, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë - konsum nga panelet solare/fotovoltaike në objektin ngastra kadastrale nr. 1700-2-631-0 ZK Çaglavicë me kapacitet të instaluar prej 5 kW në Komunën e Graçanicës, ka vlerësuar ato, dhe ka konsideruar se janë plotësuar të gjitha dëshmitë relevante për lëshimin e vendimit për ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese për vetë-konsum, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij Vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.

V. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

VI. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

**Vendimi iu dërgohet:**

- Palës,
- Komunës së Graçanicës,
- KEDS SH.A.,
- KESCO dhe
- Arkivit të ZRRE-së

**Bordi i ZRRE-së:**

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Lutfije Dervishi, anëtare

Gani Buçaj, anëtar